



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

Kom.Dh.Shk.II.nr.224/2022

GJYKATA KOMERCIALE NE PRISHTINE – Dhoma e Shkallës së Dytë, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët: Krenar Berisha, kryetar i kolegjit, Saranda Bogaj Sheremeti dhe Franciska Zhitija Ymeri anëtarë, në konfliktin administrativ sipas padisë së paditësit NTSHP B....me seli në Prishtinë, kundër të paditurës Dogana e Kosovës në Prishtinë, me bazë juridike, anulim vendimi, duke vendosur lidhur me ankesën e paditësit, të ushtruar kundër Aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë, Departamenti për Çështje Administrative Divizioni Fiskal, A.nr.1734/18 të datës 10.06.2020, në seancën e kolegjit të mbajtur me datë 13.10.2022, merr këtë;

A K T G J Y K I M

Refuzohet si e pabazuar ankesa e paditësit NTSHP B....me seli në Prishtinë, e datës 03.08.2020, ndërsa Aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë- Departamenti për Çështje Administrative-Divizioni Fiskal, A.nr.1734/18 të datës 10.06.2020, Vërtetohet.

A R S Y E T I M

Me aktgjykimin e ankimuar të Gjykatës së shkallës së parë, është refuzuar si e pa bazuar kërkesëpadia e paditësit NTSHP B....me seli në Prishtinë, ndërsa ka lënë në fuqi vendimin e Doganës së Kosovës nr.01.3.2.2/286 dt.01.06.2018

Kundër këtij aktgjykimi, në afat ligjor ankesë ka ushtruar përfaqësuesi i autorizuar i paditësit, me të cilin e konteston ligjshmërinë e tij, për shkak të: vërtetimit të gabuar të gjendjes faktike, aplikimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozim që Gjykata e Apelit, të aprovoj ankesën e parashtruar ndaj Aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë, Departamenti për Çështje Administrative-Divizioni Fiskal, dhe ta anuloj aktgjykimin e ankimuar me të cilin është refuzuar si e pabazuar kërkesëpadia e paditësit. Sipas Gjykatës paditësi nuk e ka pasur të mjaftueshëm dokumentacionin përcjellës të mallit pasi ka munguar pagesa bankare dhe kontrata. Se konstatimi i gjykatës është jo i drejtë pasi paditësi e ka kryer pagesën bankare si parapagim për të gjithë sasinë e mallit të importuar sipas DUD-ave kontestues në vlerën prej 86,136.00€ datë 26.04.2018, pagesë e cila është bërë para mbërritjes së mallit në vendin tonë dhe kjo pagesë bankare gjendet në shkresat e lëndës.

Kolegji i Dhomës së Shkallës së Dytë, vlerësoi ligjshmërinë e aktgjykimit të kontestuar si në vështrim të nenit 12 të Ligjit 08/L-015 për Gjykatën Komerciale, dhe nenit 194 i LPK-së, në drejtim të theksimeve në ankesë, dhe pas shqyrtimit edhe të shkresave tjera të lëndës gjen se;

Ankesa është e pabazuar.

Nga shkresat e lëndës rezulton se e paditura me Aktvendimin nr.01.3.2.2/286 i datës 01.06.2018, ka refuzuar kërkesën e subjektit në procedurë NTSHP B....me seli në Prishtinë, për rishqyrtimin e vendimit R-..., R-... dhe R-...të ZBD Prishtinë, si të pabazuar.

I pakënaqur me aktvendimin e të paditurit Dogana e Kosovës në Prishtinë, subjekti-tani paditësi, ushtron padi në procedurë të konfliktit administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë, Departamenti për Çështje Administrative-Divizion Fiskal. Gjykata e shkallës së parë, në këtë çështje, mbanë seancë të shqyrtimit kryesor si në vështrim të nenit 41 të LKA, në prani të përfaqësuesve të autorizuar të palëve ndërgjyqëse dhe pas administrimit të provave dhe vërtetimit të gjendjes faktike, gjatë vlerësimit të ligjshmërisë së aktvendimit të organit të paditur, merr aktgjykimin e ankimuar, me të cilin e refuzon kërkesëpadinë e paditësit si të pabazuar, ndërsa e lenë në fuqi aktvendimin e organit të paditur, nr.01.3.2.2/286 i datës 01.06.2018. Në arsyetim të aktgjykimit ndër të tjera ka theksuar se: nga provat e administruara në këtë konflikt administrativ gjykata vlerëson se nuk qëndrojnë pretendimet e paditësit se vlera e mallit kontestues është vlerë reale pasi që e paditura duke iu referuar DUD-ave ka zbatuar drejt metodën e gjashtë të vlerësimit në vështrim të nenit 35 të Kodit Doganor dhe të Akcizave të Kosovës, kur e ka ngrit bazën doganore për mallin lëndor, Paditësi është dashur që të provoj saktë me prova materiale argumentet dhe pretendimet e tij në padi, pasi që i njëjti bart detyrimin e vërtetimit të pretendimeve në padi. Në mungesë të fakteve që të vërtetohet se paditësi ka paguar vlerën e transaksionit për mallin lëndor të zhdoganuar me DUD-at kontestues, gjykata nuk ka mundur ti merr parasysh pretendimet e padis që malli të vlerësohet sipas vlerës së deklaruar në bazë të vlerës së transaksionit sipas dispozitave të nenit 33 të Kodit Doganor dhe të Akcizave 03/L-109, andaj në kuptim të drejt të kësaj dispozite ligjore shihet se paditësi nuk ka mund të argumentoj me prova konkrete mënyrën e pagesës për blerjen e mallit lëndor. Gjykata nuk ka mund të vërtetoj nje gjendje tjetër faktike nga gjendja që e ka konstatuar e paditura në procedurën administrative, pasi që paditësi nuk ka prezantuar kontratën dhe transferin bankar për mallin lëndor, pra ka paraqit dokumentacion të pamjaftueshëm që ta dëshmoj të kundërtën e konstatimeve nga vendimi kontestues.

Duke u nisur nga gjendja e tillë e çështjes qëndrimin juridik të gjykatës së shkallës së parë si të rregullt dhe të bazuar në ligj në tërësi e pranon edhe kjo Gjykatë. Kolegji vlerëson se aktgjykimi i ankimuar nuk është i përfshirë me shkelje sipas pretendimeve ankimore, as me shkelje qenësore të dispozitave të LKA-së, dhe të LPK-së, të cilat Kolegji i vlerëson, sipas detyrës zyrtare si në vështrim të nenit 12 të Ligjit 08/L-015 dhe nenit 194 të LPK-së. Kolegji gjen se gjykata e shkallës së parë ka vlerësuar drejtë ligjshmërinë e aktit përfundimtar-aktvendimit të Doganës së Kosovës, të atakuar nga paditësi, si në vështrim të nenit 9 dhe 44 të LKA-së, me të cilin aktvendim në procedurë administrative e gjithashtu edhe në procedurë gjyqësore sipas aktgjykimit të ankimuar me ankesë, në mënyrë të plotë është vërtetuar gjendja faktike, se paditësi nuk ka disponuar me dokumentacion adekuat valid për të dëshmuar vlerën reale të paguar për mallin lëndor dhe për tu bërë zhdoganimi i mallit lëndor të deklaruar me DUD-at R-..., R-... dhe R-...të ZBD Prishtinë, me metodën e parë të vlerësimit, sipas nenit 33 të Kodit Doganor dhe të Akcizave të Kosovës 03/L-109. Dëshmitë e paraqitura në procedurë të rishqyrtimit në organin e paditur dhe pranë gjykatës së shkallës së parë në konflikt administrative si faturat e mallit, deklaratat eksportuese, procesi mbi përcaktimin e vlerës së mallit lëndor, nuk mund të vërtetohet se janë bërë pagesat për faturat e mallit doganor, dokumentacioni i paraqitur nuk është i mjaftueshëm, pasi që paditësi nuk ka dëshmuar mënyrën e pagesës me prova konkrete. Andaj, nga këto fakte, Kolegji vlerëson se e paditura, Dogana e Kosovës, meqë subjekti nuk ka poseduar dokumentacion adekuat përcjellës të mallit, me të drejtë në procedurë të zhdoganimit është bazuar në të dhënat e disponueshme dhe të besueshme të Doganës së Kosovës, si dhe nga importet e mallrave të ngjashme të gjetura në

sistemin Cognos dhe Asycuda, të cilat zhdoganime kanë vlerë më të lartë të transaksionit se vlera e mallit lëndor të deklaruar, provë: DUD-at R-..., R-..., R-..., dhe me të drejtë gjykata e shkallës së parë në procedurë të konfliktit administrativ ka nxjerr konkluzionin nga provat e administruara, se dokumentacioni që ka paraqit paditësi nuk është i mjaftueshëm për tu pranuar vlera e transaksionit nga neni 33 i Kodit Doganor dhe të Akcizave të Kosovës 03/L-109.

Pretendimet ankimore të autorizuarit të paditësit sipas shkaqeve të cekura më lartë, se gjendja faktike është vërtetuar gabimisht dhe në mënyrë jo të drejtë dhe është aplikuar gabimisht e drejta materiale, si dhe theksimet ndër të tjera në arsyetim të saj, Kolegji i shqyrtoi në tërësi në baza ligjore dhe i refuzon si të pa bazuara në prova dhe fakte të dëshmuara dhe gjen se gjykata e shkallës së parë ka nxjerrë prova të mjaftueshme si në vështrim të nenit 38 të LKA-së, nga rezulton se gjendja faktike e çështjes është vërtetuar në tërësi në mënyrë të plotë dhe të drejtë. Paditësi në ankesë nuk ofron prova konkrete lidhur me kontestimin e gjendjes faktike të çështjes sipas mënyrës së vendosur si në organin e paditur Dogana e Kosovës dhe në Gjykatën e shkallës së parë. Theksimet e tjera në ankesë se dokumentacioni përcjellës i mallit lëndor ka qenë i kompletuar, dhe se përmes pagesës bankare datës 26.04.2018 është bërë parapagimi për gjithë sasinë e mallit të importuar sipas DUD-ave kontestues, dhe se në rastin konkret është dashur të bëhet vlerësimi i mallit lëndor sipas dokumentacionit përcjellës të mallit në kuptim të nenit 33 të Kodit Doganor dhe të Akcizave, Kolegji, Kolegji, po ashtu, i vlerëson si të pa bazuara, sepse në gjykatë të shkallës së parë, nga paditësi nuk është arrit të dëshmohet me provat e ofruara, një gjendje tjetër nga ajo e paraqitur në organin e paditur. Gjatë administrimit të provave materiale nga gjykata e shkallës së parë, si provë materiale e pagesës është lexuar urdhërpagesa e datës 04.05.2018, ndërsa pagesa bankare parapagim e datës 26.04.2018 e parashtruar tani me ankesë, Kolegji i Dhomës së Shkallës së Dytë, e konsideroi si provë të papranueshme pasi që e njëjta provë, nuk është administruar gjatë procedurës në konflikt administrativ. ndërsa në anën tjetër si u cek më lartë në bazë të referencave të marra nga e paditura Dogana e Kosovës, për mallin identik dhe të ngjashëm nga bursa Reuters, dhe zhdoganimet e mallrave të ngjashme në periudhë të afert kohore, që kanë vlera më të lartë se sa vlera e mallit kontestues, është konstatuar se paditësi nuk ka paraqit vlerën e transaksionit nga neni 33 i Kodit Doganor dhe të Akcizave të Kosovës.

Mbi këtë gjendje të fakteve, Kolegji i Dhomës së Shkallës së Dytë, vlerëson se gjykata e shkallës së parë dhe organi administrativ përfundimtar i paditur, Dogana e Kosovës, drejtë kanë vërtetuar gjendjen faktike të çështjes në shqyrtim dhe drejtë kanë zbatuar dispozitat e Kodit Doganor dhe të Akcizave dhe të LKA-së, dhe nuk është cenuar e drejta dhe ligji në dëm të paditësit. Pasi që me thëniet në ankesë aktgjykimi nuk vihet në dyshim, i njëjti vërtetohet si drejtë i bazuar në prova dhe ligj.

Nga të lartcekurat, e në vështrim të nenit 12 të Ligjit 08/L-015 për Gjykatën Komerciale, dhe nenit 200 të LPK-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA KOMERCIALE NË PRISHTINË
Dhoma e Shkallës së Dytë
Kom.Dh.Shk.II.nr.224/2022 me datë 13.10.2022

Kryetari e kolegjit,
Krenar Berisha